REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.10.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendos në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të 2015 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Zukë Zuka, i mbështetur nga, Udhëheqësja e Ekipit, Sabile Muli dhe anëtarët Flora Berisha dhe Naim Neziri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 7

2 Qeverisja 11

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 17

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 30

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 31

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak 33


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës tetor 2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i Pamodifikuar

Pasqyrat Vjetore Financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne terheqim vemendjen tuaj për faktin se procesimi i pagesave të subvencioneve për vitin 2015 është përcjellur me parregullsi të caktuara që lidheshin me pagesa të dyfishta ndaj përfituesve dhe me kontrolle joefikase në shqyrtimin e aplikacioneve të fermerëve.


Gjithashtu, investimet e bëra nga Agjencia Pyjore e Kosovës për menaxhimin e pyjeve publike, Ministria i kishte regjistruar si pasuri kapitale të saj edhe pse pyjet ku ishte investuar janë në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollesi në pjesën 1.2 të ketij raporti varësisht prej llojit të opinionit.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Procesi i vetvlerësimit dhe përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak janë adresuar. Megjithatë, çështja si miratimi i planit strategjik dhe përshtatshmëria e strukturës organizative duhet përmirësuar. Po ashtu mbetet sfidë edhe më tutje implementimi i plotë i të gjitha rekomandimeve.	Ministri duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet 1 dhe 2).
Kontrollet jo adekuate me rastin e përgaditjes dhe procesimit të listave për pagesa direkte ka rezultuar me procesimin e pagesave të parregullta.	Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar dhe të identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit pa gabime (shih çështjen 4).
Aranzhimet e qeverisjes nuk janë plotësisht funksionale. Vlerësimi, monitorimi dhe azhurnimi i regjistrit të rreziqeve nuk është bërë derisa aspektet tjera të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve kërkojnë përmirësim.	Ministri duhet të sigurojë që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar dhe jane implementuar, për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate lidhur me vlerësiminin dhe azhurnimin e regjistrit të rreziqeve, menaxhimit financiar dhe kontrollit (shih çështjen 3 dhe 5).



Përgjigja e Ministrit– auditimi 2015

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuara në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të gjendjes financiare të shpalosur të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194, si dhe Rregullën financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013/ për pasqyrat vjetore financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë e tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave buxhetore në Kosovë. ZAP është i pavarur nga MBPZHR dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me

këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Ne terheqim vemendjen tuaj për faktin se procesimi i pagesave të subvencioneve për vitin 2015 është përcjellur me parregullsi të caktuara që lidheshin me pagesa të dyfishta ndaj përfituesve dhe me kontrolle joefikase në shqyrtimin e aplikacioneve të fermerëve.

Gjithashtu, investimet e bëra nga Agjencia Pyjore e Kosovës për menaxhimin e pyjeve publike, Ministria i kishte regjistruar si pasuri kapitale të saj edhe pse pyjet ku ishte investuar janë në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194.

Ministri i MBPZHR është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

MBPZHR kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Draft Planin dhe Planin Përfundimtar të prokurimit;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetvlerësimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështja e ngritur në Memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 18/11/2015 në lidhje me kornizën raportuese është adresuar nga Menaxhmenti. Me përjashtim:

- Te neni 16 – Shënimi 31: Përmbledhje e pasurive jo-financiare kapitale – Komisioni ka përfunduar punën për identifikimin dhe rivlerësimin e objekteve ndërtimore për pronat e Institutit Bujqësor të Kosovës. Sipas raportit të Komisionit janë gjithsej 20 objekte, prej tyre 9 nuk kanë qenë të përfshira në regjistrin e pasurive. Ministria e Bujqësisë ka bërë kërkesë në Ministri të Financave (MF) për korrigjimin e vlerës së objekteve të rivlerësuara dhe shtimin e objekteve të identifikuara, në SIMFK. Mirëpo MF ka përmbushë kërkesën e MBPZHR me vonesë pas datës së raportimit të pasqyrave financiare të përgjithshme, dhe për këtë arsye vlera e prezantuar në PVF për pasuritë jo-financiare kapitale me vlerë mbi 1,000€ është e nënvlerësuar për 375,145€.

Në draft Pasqyrat Financiare ishte i nevojshëm korrigjimi financiar lidhur me prezantimin e vlerës për të hyrat e planifikuara:

- Te neni 13 - Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit – te shtylla Buxheti Fillestar dhe Final për të hyrat vetanake është paraqitur vlera prej 228,875€. Pasi kjo vlerë ka të bëjë me vlerën e buxhetuar për shpenzim nuk tregon vlerën reale të planifikuar për realizimin e të hyrave, prandaj në PVF duhej të paraqitet vlera e planifikimit te të hyrave prej 1,622,796€.

DEKLARATA E BËRË NGA ZKA DHE ZKF

MBPZHR ka bërë korrigjimin e sugjeruar në PVF dhe marrë parasysh këtë, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë, dhe në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto.

1.4 Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MBPZHR që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetëvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të: fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekzistojnë disa dobësi të qeverisjes brenda MBPZHR veçanërisht në lidhje me miratimin e objektivave strategjike dhe përshtatshmërinë e strukturës organizative varësisht për karakterin e aktivitetit të saj. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar nga MBPZHR, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive apo pa komente fare mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi të auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë, janë të vendosura më poshtë në raport.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të MBPZHR të vitit 2014 ka rezultuar në 15 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet. Për më tepër, Menaxhmenti i Ministrisë ishte angazhuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna në vitin e kaluar ku është përgatitur edhe dokumenti mujor mbi veprimet e ndërmarra. Megjithatë, një pjesë e rekomandimeve janë implementuar pjesërisht. Mbetet sfidë edhe më tutje adresimi i plotë i të gjitha rekomandimeve të dhëna nga ZAP.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, shtatë rekomandime janë implementuar shtatë janë implementuar pjesërisht dhe një nuk është implementuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 –Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar është implementuar edhe pse MBPZHR ka ndjekur një proces formal mujor për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të AP-ës.

Rreziku Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të vitit paraprak mund të rezultojë në vazhdimin e dobësive në kontrollet e brendshme që mund të rezultojnë në:

- Jo efikasitetin e vazhdueshëm organizativ dhe vlerën e dobët për para në praktikat për subvencionimin e përfitueseve; dhe
- Vazhdimin e kontratave për shërbime të veçanta, mbivlerësim i shpenzimeve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Rekomandimi 1 Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MBPZHR më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit të ZAP-it. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut për vitin 2015 nuk janë bërë, megjithatë në vitin 2016 janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.2;

2. Struktura organizative nuk është e përshtatshme për karakterin e aktivitetit të ministrisë, pasi është obliguar të rrit numrin e stafit me kontratë për shërbime të veçanta për 70 nëpunës, për shkak të volumit të punëve dhe kapacitetit jo të mjaftueshëm të stafit;

3. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit konsiderohen si të vendosura nga Ministria, mirëpo dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve nuk janë të plota. MBPZHR ka përgatitur planin strategjik për zhvillim rural të bujqësisë, por ky plan ende nuk është miratuar në qeveri dhe parlament; dhe

4. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura dhe të mbështetura nga Ministria.

Rreziku

Çështjet e identifikuara në aspektin e qeverisjes si mungesa e vlerësimit dhe monitorimit të menaxhimit të rrezikut dhe strukturës organizative të përshtatshme ndikojnë në proceset strategjike dhe operative dhe mund të zvogëlojnë cilësinë e aktiviteteve në ministri.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave të përmendura. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit Ministria operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies

MBPZHR ka dy Agjenci Ekzekutive: Agjencia e Pylltarisë së Kosovës (APK) dhe Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). APK është përgjegjëse për çështjet e ndërlidhura me rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, administrimin dhe menaxhimin e tokave dhe pyjeve në Parqet Nacionale në Kosovë, dhe përpilon pasqyrat financiare të cilat konsolidohen në Pasqyrat Financiare të MBPZHR. AZHB dhe APK raportojnë në baza javore tek ministri dhe mbajnë takime të rregullta, raportet janë të plota dhe japin detaje. Raportimi i brendshëm mes njësive në ministri ka tendencë të përmirësimeve të vazhdueshme.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.5.2 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në rregullën financiare të thesarit 01/2010 – Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli kërkojnë identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve relevante ndaj arritjes së objektivave që formojnë bazën për të përcaktuar se si duhet të menaxhohen rreziqet.

Çështja 3 - Zbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut – Prioritet i lartë

E gjetura Pyetësori i vetvlerësimit i plotësuar nga MBPZHR ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut për vitin 2015 nuk ishin të vendosura. Mirëpo, për vitin 2016, MBPZHR ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen e objektivave. Megjithëkëtë, deri në fund të auditimit tonë nuk është vërejtur se është bërë vlerësimi, monitorimi dhe azhurnimi i regjistrit të rrezikut.

Rreziku Mungesa e rishikimit të procesit për menaxhim të rrezikut do të zvogëlojë marrjen e sigurisë së arsyeshme që objektivat mund të arrihen me vlerën për para dhe për të mbrojtur operacionet nga rreziqet e papranueshme. Rishikimi i rregullt i menaxhimit të rrezikut dhe azhurnimi i regjistrit të rreziqeve i ofron menaxhmentit një kornizë për të udhëzuar reagimet adekuate ndaj menaxhimit të secilit rrezik në kohën e duhur.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të sigurojë se është rishikuar rregullisht procesi i menaxhimit të rrezikut dhe është azhurnuar regjistri i rreziqeve, rekomandohen rishikime tremujore, për të përcaktuar nëse janë marrë veprime ashtu siç është planifikuar dhe nëse është bërë ndonjë ndryshim në vlerësimet e rrezikut.

2.5.3 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Zyrtari Kryesor Financiar nuk përmban ndonjë softuerë të kontabilitetit, por të gjitha raportet financiare përgatiten në formatin Excel, shënimet janë të qarta, në detaje dhe të klasifikuara. Në përgjithësi, formati i raporteve menaxheriale ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore azhurnohen në baza javore.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me katër anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB dhe tre auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MBPZHR dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfida të ofruara nga një Komitet efektiv Auditimi.

Për vitin 2015, NJAB kishte planifikuar të kryej 13 auditime. Deri në fund të vitit kishte kryer 13 auditime dhe kishte nxjerrë nga një raport për secilin auditim përfshirë dy raportet shtesë me kërkesën e menaxhmentit. Auditimet kanë përfshirë periudhën e fundit të vitit të kaluar dhe vitin aktual.

Përveç finalizimit me kohë të një numri të konsiderueshëm të raporteve gjatë kësaj periudhe, ato kanë qenë cilësore dhe të bazuara në dëshmi. Raportet e auditimit përmbajnë konkluzione dhe rekomandime të cilat identifikojnë disa nga mangësitë në sistemet e kontrollit të brendshëm të ministrisë.

Po ashtu, NJAB-i kishte përgatitë raporte tre mujore, të cilat i kishte dërguar edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese në Ministri të Financave. Për më tepër në këto raporte është paraqitur edhe raporti i implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm ku shihet një progres i mirë i arritur.

Ministria ka të formuar komitetin e auditimit, i cili gjatë vitit 2015 ka mbajtur tri takime, ku janë shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm, puna e kësaj njësie dhe procesi i monitorimit të rekomandimeve të ZAP-it.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Sa i përket MBPZHR, fusha e subvencioneve mbetet shqetësim i madh, ku nuk janë duke u zbatuar rregulloret duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe në vonesat në pagesën e përfituesve. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive - por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar mbishpenzimet për të punësuarit me kontrata për shërbime të veçanta, menaxhimi i procesit për pagesa të dyfishta dhe gabimet sa i përket llogarive të përfitueseve, sjell pasiguri në kthimin e mjeteve. Regjistrimi i investimeve kapitale në regjistrin e pasurive duhet të trajtohet që të jetë në përputhje me rregullat në fuqi.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MBPZHR, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final1	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**60,152,651**	**58,801,126**	**57,520,944**	**24,158,858**	**22,471,366**
Granti i Qeverisë -Buxheti	58,601,776	53,543,987	52,643,388	17,965,268	17,231,664
Të bartura nga viti paraprak[2] –		100,580	81,328	99,953	100,572
Të hyrat vetjake[3]	228,875	228,875	146,428	158,520	110,832
Financimi nga Huamarrja	1,322,000	1,322,000	1,206,512	2,886,473	5,028,234
Donacionet e jashtme		3,605,685	3,443,289	3,048,644	65

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
[2] Të hyrat vetjake të Ministrisë të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.
[3] Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 1,351,525€. Zvogëlimi i buxhetit është rezultat i ndryshimeve të bëra gjatë vitit, Në njërën anë, buxheti ishte rritur për 3,706,265€ nga donacionet e jashtme dhe nga të hyrat e bartura të vitit paraprak, në anën tjetër, pas rishikimit buxhetor të Qeverisë buxheti është zvogëluar për 5,057,789€.

Në vitin 2015, MBPZHR ka përdorur 98% të buxhet final ose 57,520,944€, me një përmirësim prej 13% krahasuar me vitin 2014.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**60,152,651**	**58,801,126**	**57,520,944**	**24,158,858**	**22,471,366**
Pagat dhe Mëditjet	2,291,928	2,013,614	1,956,696	1,781,599	1,599,359
Mallrat dhe Shërbimet	2,808,033	3,990,472	3,692,171	3,217,591	2,678,125
Shërbimet komunale	108,768	118,735	98,207	95,368	94,344
Subvencionet dhe Transferet	53,573,922	51,555,065	50,724,157	18,338,303	16,427,920
Investimet Kapitale	1,370,000	1,123,240	1,049,714	725,996	1,671,618

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti i aprovuar për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 5,010,594€. zvogëlimi ishte bërë me rishikim të buxhetit dhe në fund të vitit fiskal.
- Buxheti për shpenzime kapitale ishte reduktuar për 646,760€, për arsye të mos arritjes së realizimit të projekteve sipas planit. Projekti për hartimin e planeve menaxhuese është realizuar me vlerë më të ulët se sa është planifikuar. Projekti për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura është anuluar menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, me kërkesën e operatorit ekonomik. Mirëpo, për të njëjtin projekt, MBPZHR ka arritur marrëveshjen me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për bashkëpunim dhe financim të 184 nëpunëseve të angazhuar në realizimin e tij.
- Buxheti për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 305,998€ me arsye se numri i planifikuar i stafit nuk është plotësuar deri në përfundim të gjashtëmujorit të parë.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Kosovës – ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,622,796	1,622,796	1,810,028	1,433,788	1,402,774
Totali	**1,622,796**	**1,622,796**	**1,810,028**	**1,433,788**	**1,402,774**

Të hyrat vetjake prej 228,875€ ishin lejuar të shpenzohen për nevojat e Ministrisë. Pjesa e mbetur e të hyrave të arkëtuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK). Totali i të hyrave të arkëtuara reflekton rritje të realizimit të hyrave për 26% krahasuar me vitin e kaluar. Pjesa më e madhe e të hyrave është realizuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës 87%, kurse pjesa tjetër është realizuar nga departamentet tjera.

Çështja 4 – Parregullsitë lidhur me pagesat direkte - subvencionet – Prioriteti i lartë

E gjetura

Buxheti për subvencione dhe transfere realizohet për pagesat direkte dhe për grante. Lista për pagesa direkte për fermerë bëhet nga Agjencia e Zhvillimit Rural (AZHB) në kuadër të ministrisë. Pas kontrollës nga ministria (zyra e financave) lista aprovohet dhe dërgohet për procesim (për pagesat e fermerëve) në departamentin e thesarit në Ministrinë e Financave.

Në vitin 2015 gjatë procesimit të pagesave për subvencione (pagesat direkte) nga thesari janë vërejtur disa parregullsi:

- Nga procedimi i Pagesave për kultura – Perime në fushë të hapur - 352 përfitues ishin paguar nga dy herë gabimisht. Vlera totale e mbi paguar gabimisht ishte 247,047€. Mbi pagesat ishin si pasojë e gabimeve në Thesar. Megjithatë, gjatë vitit 2015, pasi janë vërejtur këto gabime, Ministria ka filluar korrigjimet në departamentin e Thesarit si dhe të kërkoj kthimin e mjeteve nga përfituesit. Mbi pagesat janë kthyer nga Thesari, edhe pse procesi i kthimit të mjeteve është përcjellur me gabime në shumat e tyre. Kjo krijon pasiguri në menaxhimin e pagesave për subvencionimin e fermerëve në përgjithësi;
- Në rastin tjetër gabimet gjatë procesimit të pagesave nga thesari janë vërejtur edhe te Lista e proceduar për blegtori që kishte 255 përfitues dhe është dashur të realizohet në shumën totale 165,993€. Megjithatë, nga transaksioni i ndodhur e tërë shuma ju kishte transferuar gabimisht vetëm dy përfituesve të parë në listë. Kjo është vërejt nga MBPZHR dhe mjetet janë kthyer dhe korrigjuar nga Thesari; dhe
- Përveç çështjeve të mësipërme, ishin edhe 34 kërkesa - lista tjera për procedim të pagesave direkte të realizuara gjatë vitit 2015. Listat e fermerëve me numër të llogarisë së përfitueseve përgatiten nga AZHB. Testimet tona kanë identifikuar se në të gjitha listat e fermerëve ka gabime për disa fermerë sa i përket numrit të llogarisë së përfituesve. Kjo ka ndodhur si pasoj e kontrollit jo adekuat me rastin e përgatitjes së listave për pagesë nga AZHB.

Gjatë përpunimit të informatave rreth kthimit të mjeteve, MBPZHR ka hasur në vështirësi dhe pasiguri për të identifikuar vlerën e saktë të mjeteve të mbi paguara dhe që do të duhej të ktheheshin nga përfituesit individual. Nga Ministria e Financave (Departamenti i Thesarit) janë regjistruar kthimet për të

njëjtin fermer nga dy, tre e katër herë, pa specifikuar nëse mjetet e tyre janë kthyer vetëm për shumën e pranuar si të dyfishtë apo si total. Po ashtu, ka raste kur prej të njëjtës listë për pagesë, për disa fermerë është bërë ri procedimi e për disa fermerë jo.

Rreziku Mangësitë e paraqitura në realizimin jo të rregullt të buxhetit për shkak të gabimeve në pagesa për përfituesit e cekur më lartë duken mjaft shqetësuese. Kjo do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës, në keq menaxhim të parasë publike, pasiguri dhe vonesa të pagesave dhe në dëmtim të reputacionit të ministrisë ndaj përfituesve për subvencione dhe grante.

Rekomandimi 4 Ministri duhet të sigurojë, në bashkëpunim me MF, trajtimin me urgjencë të te gjitha pagesave të parregullta të subvencioneve përfshirë gabimet dhe paqartësitë tjera sistematike të ndodhura gjatë procesimit të tyre për të identifikuar burimin e paraqitjes së problemit, madhësinë e tij si dhe masat e duhura korrigjuese dhe për kthimin e mjeteve të mbi paguara. Më tutje, të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike dhe me kohë për të parandaluar dhe/ose për të identifikuar me kohë përsëritjen e parregullsive gjatë procesimit të pagesave. Njëkohësisht të konsiderohet një trajtim i përbashkët i mundësisë për delegimin e këtyre pagesave në MBPZHR nëse kjo do të ishte më e përshtatshme, me qëllim të parandalimit dhe evitimit të këtyre parregullsive. Në anën tjetër, para se të procesohet lista e fermerëve për pagesë, AZHB duhet të siguroj konfirmimin nga secili fermer përfitues i subvencionit se llogaria bankare e paraqitur është në rregull dhe aktive.

Çështja 5 – Klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve në kodet ekonomike brenda kategorisë së njëjtë- Prioriteti i Mesëm

E gjetura

Shpenzimet për subvencione me listë të fermerëve në vlerë prej 747,534€ janë klasifikuar në kodin ekonomik joadekuat. Ato janë regjistruar si subvencione për entitete jopublike" (në kodin ekonomik 21200) ndërsa është dashur të regjistroheshin si pagesa për kulturat (në kodin ekonomik (23130).

Mirëpo sipas kërkesës së Ministrisë, prill 2014, Thesari ka krijuar nën kode tjera për ndarje të subvencioneve, granteve dhe subvencione të entiteteve jopublike. Kjo ndarje do e mundësoj klasifikimin korrekt të tyre.

Përveç kësaj, edhe shpenzimet e mëposhtme janë regjistruar në kodin ekonomik joadekuat si "shërbime kontraktuese tjera":

- "shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit" ne vlerë prej 2,942€;
- "furnizimet me pajisje të TI-së" në vlerë prej 9,688€; si dhe
- "shërbimet këshilluese dhe individuale" në vlerë prej 35,858€.

Rreziku

Regjistrimi i shpenzimeve në kode të pasakta e rrit rrezikun që të mos arrihet qëllimi i synuar i shpenzimeve dhe zvogëlon efektivitetin e menaxhimit buxhetit. Njëkohësisht, kjo ndikon edhe në shpalosjen jo të saktë të informatave në PVF sipas nënkategorive ekonomike.

Rekomandimi 5

Ministri duhet të siguroj klasifikimin e transaksioneve sipas kodeve të reja ekonomike të përcaktuara nga Thesari si dhe të forcoj kontrollet financiare për evituar gabimet lidhur me regjistrimet e shpenzimeve dhe raportimin e tyre.

3.4 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndështkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Për vitin 2015 janë nënshkruar 61 kontrata, me vlerë të parashikuar prej 2,840,389€. Prej tyre 39 kontrata janë nënshkruar nga Ministria dhe 22 kontrata janë nënshkruar nga APK. Në total shpenzimet përmes prokurimit ishin në vlerë prej 1,048,847€. Në nivel të shpenzimeve të përgjithshme të ministrisë, shpenzimet për investime kapitale marrin pjesë vetëm me 2%.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet të cilat nuk shkojnë përmes procedurave të prokurimit janë shpenzimet komunale, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet për shërbime të caktuara si arsimi, publikimi, anëtarësimi etj.

MBPZHR ka të punësuar 70 nëpunës me kontratë për shërbime të veçanta të cilëve ju vazhdohet kontrata vit pas viti dhe paguhen përmes kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Kjo çështje është trajtuar në raportet tona të auditimit në vitet e kaluara dhe janë dhënë rekomandimet për sistemimin adekuat të tyre.

Për realizim të projektit "Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura" nga APK janë angazhuar 184 nëpunës, në marrëveshje me MPMS. Këta nëpunës janë të zgjedhur nga enti i punësimit, pagat e tyre realizohen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve Ne kemi testuar një numër mostrash dhe nuk kemi hasur në gabime materiale në këtë fushë.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollet kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave bëhen nga Divizioni i pagave në Ministria e Financave derisa organizata buxhetore bën aprovimin e listës për paga dhe mëditje.

Sipas shënimeve te SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 2,013,614€, dhe shpenzimet ishin 1,956,696€ ose 97%. Numri i nëpunëseve të planifikuar ishte 323, ndërsa numri aktual në fund të vitit 2015 ishte 313.

Çështja 6 – Sistematizimi i vendeve të punës – Prioritet i mesëm

E gjetura Nuk ka përputhshmëri në mes të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës, Ligjit të buxhetit dhe shënimeve për pagat – Payrollit. Ndryshimet vërehen në numrin e të punësuarve në kabinetin e ministrit, por kjo nuk reflekton në totalin për organizatën. MBPZHR me rastin e planifikimeve buxhetore ka bërë përpjekjet për këtë çështje. Megjithatë, kjo nuk ka ndryshuar gjendjen e numrit të punësuarve me rastin e aprovimeve buxhetore.

Rreziku Mos aprovimi i kërkesave buxhetore nga MF ndaj kërkesave për sistematizimin e vendeve të punës, ndikojnë në realizimin e procesit buxhetor dhe në arritjen e objektivave të Ministrisë duke reflektuar edhe në zhvillimin e operacioneve primare.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të konsideroj që me rastin e planifikimit të buxhetit, të vazhdoj përpjekjet me MF dhe të paraqes arsyet me rastin e aprovimeve buxhetore për nevojat e stafit sipas departamenteve dhe të siguroj se kërkesat buxhetore lidhur me numrin e të punësuarve janë në përputhje me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Subvencionet ndërlidhen me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë që kanë për qëllim zgjerimin dhe përmirësimin e prodhimtarisë së tyre. Pagesa e subvencioneve bëhet në formë të pagesave direkte (në Thesar) dhe në formë të granteve nga zyra e financave në MBPZHR.

Politikat dhe buxheti përgatiten nga Autoriteti Menaxhues në bashkëpunim me Ministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm (SP) ndërsa Implementimi i politikave bëhet nga AZHB-ja.

Çështja 7 – Kriteret e vlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura

Nga testimi i vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmive për përfitimin e grantit "Ujitja e Tokave Bujqësore" në vlerë 160.000€, kemi vërejtur parregullsi në poentimin e përfituesit. Në fakt, në pikën e parë të vlerësimit[4] përfituesi është poentuar me 5 pikë edhe pse sipas kritereve përzgjedhëse nuk i ka takuar asnjë pikë[5]. Pastaj te pika tjetër lidhur me dëshmitë për "numrin e fermerëve tjerë që do të përfitojnë nga ky projekt" është bërë llogaritja me pikë maksimale 20 pikë, ndërsa nuk kishte dëshmi se nga ky investim do të përfitojnë edhe të tjerët. Poentimi në këto dy aspekte të vlerësimit ka qenë kritik për përzgjedhjen e fituesit.

Në një rast tjetër është vërejtur vlerësim dhe refuzim i paqartë i një aplikacioni për masën 103.1(Trashja e viqave). Aplikacioni është vlerësuar negativ (refuzuar) me arsyetimin se fermeri nuk e plotësonte kriterin e përvojës në bujqësi. Po ashtu fermeri për refuzim nuk ishte informuar. Fermeri ishte i regjistruar në sistemin e AZHB-së si përfitues para tre viteve, gjë që dëshmon plotësimin e kriterit të përvojës në bujqësi dhe nuk ishte i obligueshëm të sjell dëshmi tjetër. Megjithatë, jo drejtë ankesa e fermerit është refuzuar nga AZHB.

Rreziku

Miratimi i projektit i cili nuk i plotëson kushtet administrativisht dhe kriteret e vlerësimit mund të ketë për pasoj humbje financiare, eliminimin e përfitueseve dhe projekteve tjera që ndikojnë në zhvillimin e sektorit bujqësor. Në anën tjetër, dobësitë në sistemin vlerësues dhe mos informim me kohë i fermerëve të refuzuar tregon jo transparencë në marrjen e vendimeve dhe ndikon në dëmtimin e fermerëve aplikues.

Rekomandimi 7

Ministri dhe Kryeshefi Ekzekutiv duhet të sigurojnë që vlerësimi i aplikacioneve për grante bëhet në bazë të kërkesave dhe dokumentacionit të paracaktuar, notimi mbështetet në analizat e dokumentuara dhe si përfitues përzgjidhen aplikuesit më të përshtatshëm për arritjen e objektivave të synuara. po ashtu duhet të sigurohet që ankesat e aplikuesve të rishikohen dhe trajtohen drejt në mënyrë që të shmangen parregullsitë e mundshme.

[4] Pika e parë e vlerësimit për " Kostot – efektive për zgjerimin e sipërfaqeve të ujitura"

[5] Kjo ndërlidhet me kriterin se projekti i cili është me kosto më të ulët do të marr numrin maximal të pikëve , ndërsa projekti me kosto më të lartë për hektar do të marr 0 pikë. Ndërsa, përfituesi ka qenë me kosto më të lartë për projekt dhe është dashtë të poentohet me 0 pikë.

Çështja 8 – Pranimi i aplikacioneve në zyrat regjionale - Prioritet i lartë

E gjetura UA 01/2015, zyrat regjionale përkatëse për bujqësi janë përgjegjëse që të kontrollojnë kompletimin e aplikacioneve të fermerëve. Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti të detyrueshëm zyrtari i AZHB-së nuk duhet ta pranoj aplikacionin, por e regjistron aplikuesin dhe e njofton për dokumentet që i mungojnë në mënyrë që aplikuesi të ketë mundësi ti kompletoj deri në përfundim të afatit për aplikim. Në zyrat regjionale të AZHB-së janë pranuar aplikacionet me gabime prandaj, nga gjithsej 2130 aplikacione të pranuara për grante, 950 ishin refuzuar nga zyra për miratim në AZHB. Kjo situatë është shkaktuar si pasoj e kontrollit jo adekuat e që është reflektuar nga mungesa e personelit të pamjaftueshëm.

Rreziku Dobësitë gjatë kontrollit të dosjes gjate kohës së aplikimit të fermerëve, shfaqin devijime nga UA që si rezultat mund të mohoj të drejtën e aplikuesit për sjelljen e dokumenteve shtesë dhe të eliminimit të projekteve që mund të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin sektorial.

Rekomandimi 8 Ministri dhe Kryeshefi Ekzekutiv duhet të sigurohen se zyrtarët regjional kanë aplikuar kontrollet adekuate me rastin e pranimit të aplikacioneve nga fermerët, me qëllim të tu epet mundësia gjithë fermerëve për korrigjimet në aplikacione apo në ofrimin e dokumenteve shtesë. Kjo do të shpie në efektin e arritur ashtu siç parashihet edhe me udhëzimet përkatëse. Në anën tjetër të konsideroj staf të mjaftueshëm për arritjen e objektivave të caktuara.

Çështja 9 – Monitorimi i projekteve (granteve) – Prioritet i lartë

E gjetura Sipas programeve për vite dhe Udhëzimit Administrativ (UA) 01/2015 të Ministrisë, grantet që u jepen fermerëve duhet të monitorohen së paku një herë brenda pesë viteve. Megjithatë, nga të dhënat e kontrollit në ministri (AZHB) monitorimi i grandeve nuk jep siguri se janë realizuar kontrollet e duhura sipas UA. Në vitin 2015, divizioni i kontrollit në teren (në kuadër të AZHB-së) kishte bërë vetëm 17 kontrolle për projektet e viteve 2013-2014. Bazuar në numrin e madh të miratimit të granteve, niveli i kontrolleve të tilla konsiderohet i pamjaftueshëm për mbulimin e të gjitha projekteve të subvencionuara. Për më tepër kjo është e nevojshme pasi që kontrollet e aplikuara në vitin 2015 kishin identifikuar parregullsi rreth përmbushjes së kontratës nga ana e fermerëve si dhe shitje të mjeteve të subvencionuara nga ministria. Sipas AZHB-së, numri i pamjaftueshëm i burimeve njerëzore paraqet hapësirë të kufizuar në arritjen e objektivave të caktuara.

Rreziku Monitorimi i pa mjaftueshëm i granteve për një periudhë sa është brenda kohës së paraparë me udhëzues mund të ndikoj në shfrytëzimin e tyre për qëllime tjera nga ato të synuara si dhe pamundësinë për identifikimin e devijimeve dhe korrigjimin e tyre me kohë apo keqpërdorimi i subvencioneve dhe granteve të përfituara nga fermerët.

Rekomandimi 9 Ministri dhe Kryeshefi Ekzekutiv duhet të sigurojnë rritjen e aktiviteteve monitoruese të grandeve, monitorimet pasqyrojnë rrezikun e vlerësuar dhe ato të kryhen rregullisht dhe me kohë. Në anën tjetër të konsideroj edhe kapacitetet e mjaftueshme të burimeve njerëzore për arritjen e rezultateve të duhura.

Çështja 10 – Mangësitë në listën kontrolluese të dokumenteve të dorëzuara – Prioritet i mesëm

E gjetura Dobësitë në informimin e fermerëve për aplikim është vërejtur edhe te grandet të cilat ndërlidhen për Investimet në asete fizike. Kërkesat që janë paraqitur në listat kontrolluese[6] për dokumentet e nevojshme nga përfituesit nuk janë të njëjta me kërkesat që parashihen me U.A 01/2015. Si pasojë e informimit jo të drejtë, në disa raste kishte ankesa të shumta drejtuar komisionit për ankesa në AZHB. Megjithatë, zyra për miratim kishte kthyer përgjigje negative pasi me U.A dhe Udhëzuesin për aplikant fermerët nuk kanë plotësuar kriteret e caktuara.

Rreziku Mos informimi me kohë i fermerëve për dokumentet e kërkuara dhe mos specifikimi në listën kontrolluese rrit rrezikun që të dëmtohen disa fermerë aplikues dhe njëkohësisht të ketë mundësi në favorizimin e të tjerëve.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të konsiderojë që Autoriteti Menaxhues në ministri dhe Kryeshefi Ekzekutiv kanë rishikuar konsistencën e Udhëzimit Administrativ, udhëzuesit dhe listës kontrolluese të dokumenteve me qëllim që të kërkohen specifikime të detajuara nga fermerët me rastin e aplikimit.

[6] Listat kontrolluese janë dokument në bazë të të cilës poentohen aplikacionet e fermerëve për plotësimin e kritereve që duhet të jenë të ngjashme me UA.

3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Të hyrat e realizuara nga MBPZHR në 2015 ishin në vlerë 1,810,028€. Ato kanë të bëjnë me taksat drusore, qiraja, lëshimi i licencave etj. Të hyrat depozitohen në buxhetin e Kosovës, regjistrohen në SIMFK. Vlera e shpenzuar nga të hyrat është 228,006€ duke përfshirë dhe të hyrat e bartura nga viti 2014.

Çështja 11– Mungese e softuerit – Prioritet i lartë

E gjetura Edhe pas rekomandimit të ZAP-it, Ministria dhe APK nuk posedon softuer për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave vetanake. Të dhënat manuale ekzistuese përpunohen dhe përcillen në format të MS Excel apo të ndryshme. Në shumë raste, të dhënat e kontabilitetit, përfshirë detajet e mbledhjes dhe bilancet e bartura nga viti paraprak mund të mos janë regjistruar siç duhet.

Rreziku Informatat aktuale për të hyrat vetanake mund të mos jenë të sakta ose të plota dhe nuk vihen në dispozicion në kohën e duhur për ta mbështetur vendimmarrjen e menaxhmentit. Sistemet manuale ekzistuese për grumbullimin e informatave në lidhje me të ardhurat t'i nënshtrohen gabimeve.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të regjistrimit, që mbështet mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Një vlerësim duhet të bëhet bazuar në kompleksitetin e njohur të operacioneve ekzistuese, për ta përcaktuar nëse kjo duhet të bëhet me anë të softuerit.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrit të pasurisë kapitale (mbi 1000€), MBPZHR, ka në pronësi pasuri kapitale me vlerë në libra prej 37,036,679€. Ndërsa në regjistrin e pasurisë jo kapitale (nën 1,000€) MBPZHR, ka të prezantuar 274,438€ si pasuri jo kapitale. Stoqet janë 17,000€.

Inventarizimi i pasurisë së MPBZHR-se është kryer në janar 2016. Raporti i komisionit për inventarizim ka identifikuar pasurinë e plotë të MBPZHR-se duke përfshirë edhe disa pajisje të cilat janë jashtë përdorimit. Heqjet gjatë vitit kanë qenë 10 vetura të cilat janë shitur përmes një ankandi publik të realizuar në mars 2015.

Çështja 12– Regjistrimi i shpenzimeve për menaxhim dhe administrim të pyjeve publike - Prioritet i mesëm

E gjetura Në kuadër të buxhetit për Investime Kapitale, Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) për secilin vit krijon shpenzime sipas planeve menaxhuese për pyjet publike dhe tokat pyjore si p.sh. pyllëzimet e sipërfaqeve të zhveshura dhe mirëmbajtja e pyjeve. APK këto investime kapitale të kryera në pyjet dhe tokat pyjore që nuk janë në pronësi të saj i ka regjistruar si kapital tjetër në regjistrin e pasurisë. Sipas rregullave financiare organizata buxhetore financuese duhet të regjistroj transaksionin në kategorinë e investimeve në vijim deri në momentin e përfundimit të pasurisë, e pastaj t'i transferohet organizatës përkatëse[7].

Rreziku Regjistrimi i shpenzimeve si kapital tjetër në regjistrin e pasurisë e mbivlerëson vlerën e pasurive të APK-së.

Rekomandimi 12 Ministri dhe Kryeshefi i APK-së duhet të konsiderojnë se investimet e kryera kapitale regjistrohen në regjistrin e pasurisë si investime në vijim dhe në momentin që projekti kapital përfundon, i tërë investimi kapital duhet të bartet në regjistrin e pasurisë ku pyjet janë të regjistruara. Për më tepër kjo çështje duhet të trajtohet me entitetet relevante që kanë nën administrim tokat pyjore.

[7] Tokat pyjore të cilat janë në pronësi të ish ndërmarrjeve Shoqërore, tani janë nën administrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Të hyrat e pa mbledhura dhe të prezantuara në PVF ishin 1,446,269€. Prej tyre 1,288,526€ janë obligime të pa mbledhura nga vitet paraprake, prej operatorëve të cilëve ju ka ndërpre kontrata dhe janë të paditur, ndërsa 157,743€ janë Obligime vijuese të operatorëve të cilët janë aktiv, por kanë obligime për 2015.

MBPZHR, bazuar në kornizën ligjore, ka përdorur të gjitha procedurat e mundshme për të inkasuar të arkëtueshmet e tyre. Në raste të mos ekzekutimit të urdhrave dhe dënimeve nga shkelësit/kundërvajtësit, MBPZHR, ka proceduar inicimin e procedurave gjyqësore pranë gjykatës kompetente.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7.3 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 9,299,508€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Pjesa më e madhe e detyrimeve ka të bëjë me fushën e subvencioneve dhe transfereve. Krahasuar me vitet e kaluara këtë vit detyrimet e bartura janë zvogëluar për 50%.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo te implementuara	Të pa adresuara
1. Rreziqet domethënëse në PVF				
Pasuritë nën pronësi të MBPZHR nuk janë identifikuar dhe regjistruar në mënyrën e duhur.	Ministri duhet të siguroj identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e plotë të pronave që janë nën kompetencë të ministrisë përkatësisht të IBK-së.		Ministri ka marr masa, komisioni ka bërë identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e plotë të pronave te IBK-së. Për shkak te mos regjistrimit me kohe ne SIMFK nga MF, diferenca e këtyre pasurive nuk është prezantuar ne PVF.	
Vonesa për kryerjen e pagesave për subvencione – ndikimi në rritjen e vlerës për obligimet e papaguara.	Ministri duhet të iniciojë një analizë, arsyet për vonesat në pagesën e subvencioneve si dhe të identifikojë dhe të ndërmerr veprime të nevojshme për të siguruar pagesën me kohë pasi është parakusht për pranimin e donacioneve të nevojshme.		Ministri ka marr masa ne realizimin e pagesave me kohë, megjithatë ende mbesin obligime të bartura për vitin vijues.	
2. Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF 2015 të përfshijë rishikimin e hollësishëm të draft llogarisë nga menaxhmenti. Po ashtu duhet të ofrojë shqyrtim formal të letrave mbështetëse të	Rekomandimi është implementuar, raporti i ekzekutimit të buxhetit, te shtylla e donacioneve është		

	punës para se PVF-të të dorëzohen. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse në të gjitha draft PVF janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	paraqitur vlera e buxhetuar e donacioneve; dhe është bërë shpalosja e detyrimeve të papaguara dhe detyrimeve ligjore.		
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Ministria ishte angazhuar për implementimin e rekomandimeve të vitit paraprak, dhe me kërkesën e menaxhmentit bëhet çdo muaj përcjellja e nivelit të zbatimit të tyre nga departamentet përkatëse me ndihmën e AB. Deri më tani pjesa më e madhe e rekomandimeve janë adresuar pjesërisht, mbetet sfidë edhe më tutje adresimi i plotë i të gjitha rekomandimeve të dhëna.	
4. Qeverisja	Ministri duhet të sigurojë që të bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të qeverisjes dhe të kërkesave shoqëruese të raportimit të brendshëm në Ministri. Cilësia e çështjeve që ndërlidhen me këtë si raportimi i brendshëm duhet të rishikohen me kujdes për të siguruar një menaxhim efektiv operativ të Ministrisë dhe arritjen e objektivave strategjike.	Rekomandimi është implementuar.		

4.2 Planifikimi dhe Realizmi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë se arsyet për realizim të ulët të buxhetit në vitin 2014 janë analizuar në mënyrë të hollësishme. Duhet të elaborohen masat e nevojshme për menaxhim më të efektshëm të buxhetit. Për më tepër, të iniciojë monitorim sistematik të performancës së donacioneve dhe të identifikoj dhe adresoj barrierat për të rritur efikasitetin në vet procesin.	Rekomandimi është implementuar.		
4.4 Shpenzimet **4.4.1 Prokurim**	Ministri duhet të analizojë arsyet për dobësitë e identifikuara dhe duhet përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit. Realizimi i punëve/shërbimeve (menaxhimi i kontratave) duhet mbikëqyrur në mënyrë që të jenë sipas kushteve të parapara.	APK ka aplikuar ndëshkimet për ditët në vonesë ashtu siç ishte paraparë me kontratë. Renovimi i objektit ka përfunduar me rreth 8 muaj vonesë. APK për vonesa ka aplikuar ndëshkimet në vlerë prej 6,124€. Për projektin "Pyllëzimi vjeshtor në sipërfaqet e zhveshura" ende nuk ka vendim te gjykatës.		
4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të analizojë arsyet sa i përket pagesave nga Fondi i Kuadrove bazuar në vendimet e marra viteve të mëhershme dhe të zbatojë kontrolle të shtuara për t'u siguruar që pagesat janë bërë në përputhje me rregullat ligjore në fuqi.	Rekomandimi është implementuar.		

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse proceset e subvencionimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë e identifikuara janë adresuar. Njëkohësisht të konsideroj se kriteret sipas UA a janë të përshtatshme për zbatimin e politikave të zhvillimit të bujqësisë.		Për projektin e ujitjes janë zhvilluar procedurat e prokurimit nga ministria, deri më tani procesi nuk ka përfunduar ende. AZHB këtë vit kishte çmimoren dhe ishte bazuar ne të.	
	Ministri duhet të rishikojë modelet aktuale te planeve dhe të beje korrigjime me qellim qe te kërkohen specifikime te detajuara nga fermerët me rastin e aplikimit.		Plan biznesi vazhdon të mbetet i njëjtë, kurse projekt propozimi është përmirësuar në disa fusha specifike.	
	Ministri duhet të forcoj kontrollet rreth subvencioneve për të siguruar se ato jepen vetëm për qëllime dhe rezultate të synuara Përveç kësaj, zbatimi i marrëveshjeve me OJQ-të e subvencionuara duhet të monitorohen dhe përcillen nga afër. Nxjerrja e një udhëzuesi të brendshëm, duke përfshirë një shabllon për marrëveshje e cila mund të jetë e dobishme në trajtimin e mangësive ekzistuese.			Prapë janë subvencionuar OJQ-të të cilat nuk plotësojnë kriteret sipas UA. Ministria ka subvencionuar dy organizata të cilat nuk kanë aktivitetin e tyre si shoqata të cilat merren me prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe agro ushqimore , dhe të cilat ishin të vlerësuar si të papërgjegjshme nga komisioni për vlerësim dhe selektim.

	Ministri duhet të siguroj se puna e kryer të paguhet ashtu siç parashihet me marrëveshjen ekzistuese të bashkëpunimit me fakultetin ekonomik. Përveç kësaj, marrëveshjet ekzistuese duhet të rishikohen për atë nëse ende ekziston nevoja për angazhim të studentëve dhe nëse ka buxhet të mjaftueshëm në dispozicion për pagesa të tilla në të ardhmen.		Pagesat e studenteve për vitin 2014 nuk janë realizuar, mirëpo këtë vit me mbështetjen e projektit të Bankës Botërore, në AZHB janë angazhuar me pajtimin e tyre studentët e njëjtë, të cilët këtë vit po kompensohen me shumë më të lartë se që ishte paraparë vitin e kaluar.	
	Ministri duhet të sigurohet se komisioni për ankesa raporton rregullisht për gjendjen e ankesave të fermerëve gjegjësisht për trajtimin e tyre në mënyrë që të ketë një pamje më gjithëpërfshirëse rreth menaxhimit të subvencioneve të nevojshme për vendimmarrje dhe mbikëqyrje.		Komisioni i ankesave ka përgatitur raporte, por jo ne detaje, ne rastet kur janë refuzuar fermerët nuk ka dhënë informata pse janë refuzuar, por vetëm me një konkluzion te përgjithësuar "në mungese të fakteve refuzohen".	
4.5 Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet te siguroj që është bërë inventarizimi i plotë i pasurive jo-financiare para përfundimit të vitit në baza vjetore..	Inventarizimi është kryer me kohe.		
4.6 Sistemi i auditimit te brendshëm	Ministri të siguroj se janë marrë masa shtesë nga komiteti i auditimit në drejtim të shtyrjes së implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm në një shkallë më të madhe.	Ministria ka marr masa në monitorimin e vazhdueshëm lidhur me zbatimin e rekomandimeve si të NJAB dhe e ZAP.		